

Për:	Operatorë Ekonomik: AG Construction Shpk me adresë në Malishevë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	26.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **26.08.2022**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **AG Construction Shpk**, me adresë në: **Malishevë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **AG Construction Shpk**, me adresë në: **Malishevë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **01.08.2022**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **AG Construction Shpk**, me adresë në: **Malishevë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM**, me Numër të prokurimit: **623-22-6778-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-22-025-5-1-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **01.08.2022**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **26.08.2022**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Ne baze te pretendimit tuaj se asnjë Autoritet Kontraktues nuk i lejohej qe te lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju sqaron se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): tek Neni 19.1(h) – i Dosjes se tenderit: Dokumentet qe përbejnë Tenderin, kemi cekur: ***Në pamundësi teknik për të ngarkuar në sistem e prokurimit projektin detal, ju informojmë se komplet projektin mund te merrni ne Zyrën e Prokurimit – Komuna e Rahovecit, ne forme fizike.***

Ne si AK: Komuna e Rahovecit, ju ftojmë ju si Operator Ekonomik se komplet projektin mund te merrni ne Zyrën e Prokurimit – Komuna e Rahovecit, ne forme fizike.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi

Menaxher i Zyrës se Prokurimit

Komuna e Rahovecit